

BASHKIA TIRANË

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë në mbështetje të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, me datë 15.01.2018 Ora: 11:00, realizoi hapjen e ofertave për procedurën e koncesionit/PPP me objekt: “Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës“Për Projektimin , Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e katër objekteve arsimore në Zonën Tirana 2” me Vlerë të Projektit: 1.574.138.127(një miliard e pesëqind e shtatëdhjetë e katër milion e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e njëqind e njëzetë e shtatë) Lekë pa TVSH.

Komisioni i Koncesionit/Partnerit Privat Publik nga shqyrtimi i ofertës së paraqitur për procedurën me objekt “Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës“Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e katër objekteve arsimore në Zonën Tirana 2”, në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Koncesionin/Partnerit Privat Publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpalli atë të pa vlefshme pasi nuk plotësonin kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarte të koncesionit.

Komisioni i Koncesionit/Partnerit Privat Publik ndodhur në këto kushte në mbështetje të nenit 24 pika 1 gërma (ç) të ligjit nr 9643 për “Koncesionit/Partnerit Privat Publik” (i ndryshuar) si edhe VKM Nr 914 dt 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar), neni 73, pika 1, vendosi të anullopjë këtë procedurë Koncesionit/Partnerit Privat Publik pasi referuar përcaktimit të bërë në dispozitat e mësipërme thuhet se:

“Nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit “ si dhe “Që të vazhdojë procesi i përzgjedhjes së fituesit në një procedurë prokurimi duhet të pranohet të paktën një ofertë e vlefshme”.

Sa më sipër duke qënë se ofertat e paraqitura rezultuan të pavlefshme për arsyet e sipërcituara, Komisioni i Koncesionit/Partnerit Privat Publik vendosi të anullopjë Koncesionin/Partneritet Privat, Publik me objekt: “Për Përmirësimin e Infrastrukturës Arsimore në Bashkinë e Tiranës“Për Projektimin, Financimin, Ndërtimin, Mobilimin, Mirëmbajtjen, Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e katër objekteve arsimore në Zonën Tirana 2”.